



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:144142
Datë: 30.07.2024
Numri i dokumentit: 05997820

PA1.nr.947/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Abdullah Ahmeti, kryetar i kolegjit, Mehmet Ndrecaj, dhe Skender Çoçaj anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Ilmije Rexhepi Beqiri, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.F nga Graçanica, për shkak të veprës penale Blerja, pranimi dhe fshehja e sendeve të përfituara me vepër penale nga neni 333 par. 2 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit F.F, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.1807/2022, datë: 19.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **23.07.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të akuzuarit F.F, ndërsa aktgjykimi Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.1807/2022, datë: 19.03.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykatë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.1807/2022, datë: 19.03.2024, të akuzuarin F.F, e ka shpallur fajtor për veprën penale Blerja, pranimi dhe fshehja e sendeve të përfituara me vepër penale nga neni 333 par. 2 të KPRK-së, dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim, konform nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e personit të dënuar, dënimi me burgim, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) euro, i cili dënim duhet të paguhet brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë, nen kërcënimin e përmbarimit me dhunë. Pala e dëmtuar, N.G, më vendbanim në Prishtinë, lidhur me kërkesën pasurore juridike,

udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil. Obligohet i akuzuari që t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale, ashtu që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20.00 (njëzet) Euro, në emër të taksës për programin e kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 20.00 (njëzet) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur :

I akuzuari F.F, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke i propozuar kolegjit penal të Gjykatës së Apelit që ta aprovojë ankesën dhe ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar, dhe të pandehurit ti shqiptohet një dënim më i ulët.

Prokuroria e Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.948/2024, të dt. 19.06.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit, ndërsa aktgjykimi të vërtetohet.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të KPPRK-së, konstatoj se:

- ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit, duke u bazuar në nenin 394 par. 1 të KPPRK-së, sipas detyrës zyrtare, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe në këtë drejtim, dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar është përpiluar në harmoni të plotë me dispozitat ligjore nga neni 369 i KPPRK-së, dispozitivi i aktgjyimit të ankimuar është i qartë, në dispozitivin e këtij aktgjykimi janë përshkruar qartë të gjitha veprimet inkriminuese të të akuzuarit, në të cilat veprime manifestohen të gjitha elementet qenësore të kësaj vepre penale, për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor i akuzuari. Po ashtu dispozitivi i aktgjyimit të ankimuar nuk është në kundërshtim me vetveten e as me arsyetimin e të njëjtit, në arsyetimin e aktgjyimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka paraqitur në mënyrë mjaftë të plotë dhe të qartë të gjitha arsyet përkitazi me faktet vendimtare me rastin e vendosjes në këtë çështje penale.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase as me ankesë nuk ka mund të kontestohet, për faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë, dhe gjyqtari i vetëm gjykues e ka aprovuar një pohim të tillë, dhe bazuar në nenin 383 par.2 të KPPRK-së, aktgjykimin e ankimuar e vlerësoj vetëm në bazë të pretendimeve në ankesë të parashtruara nga i akuzuari.

Po ashtu aktgjykimi i ankimuar nuk është goditur as për shkak të shkelje të ligjit penal, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit, duke u bazuar në nenin 394 par. 1 të KPPRK-së, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe sipas detyrës zyrtare për shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë as me shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, në radhë të parë për faktin se nga pranimi i fajësisë nga i akuzuari dhe aprovimi i këtyre deklaratave nga Gjykata e shkallës së parë, është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, dhe me këtë rezulton se është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë manifestuar elementet qenësore të kësaj vepre penale për të cilën është shpallur fajtor dhe gjykuar i akuzuari, si dhe për faktin se kjo vepër për të cilën është gjykuar i akuzuari është vepër penale, nuk ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit, dhe ndjekjen penale për këto vepra penale, dhe as zbatim të gabuar të Kodit Penal.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e të akuzuarit që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ulët janë të pabazuara, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar dhe konstatuar drejtë të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ku si rrethanë lehtësuese ka marrë pranimin e fajësisë të bërë në shqyrtimin fillestar. Gjykata e Apelit këtë konstatim të Gjykatës së shkallës së parë e vlerëson si të drejtë dhe në proporcion me dënimin e shqiptuar nga e njëjta. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë e cila do ta arsyetonte shqiptimin e dënimit më të ulët për të akuzuarin.

Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë, të cilat rrethana i aprovon edhe kolegji penal i kësaj gjykate, edhe bazuar në rrethanat relevante ekzistuese në rastin konkret, dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, është dënim i drejtë, i ligjshëm, në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale të kryer dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe se kolegji penal i kësaj gjykate, vlerëson se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, e i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, në kuptim të nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.947/2024, me datë 23.07.2024

Bashkëpunëtorë Profesionale

Ilmije Rexhepi Beqiri

Kryetari i kolegjit

Abdullah Ahmeti

Antarët e kolegjit:

Mehmet Ndrecaj

Skender Çoçaj